



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO

**GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT**

Prishtinë, më 23 qershor 2022
Nr. ref.:RK 2010/22

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

rastin nr. KI154/21

Parashtrues

Eset Berisha

Vlerësim i kushtetutshmërisë

**së Aktvendimit të Gjykatës Supreme, Rev. nr. 107/21 të 16 marsit 2021 në lidhje
me Aktvendimin Ac. nr. 4710/20 të 12 nëntorit 2020 të Gjykatës së Apelit**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Gresa Caka-Nimani, kryetare
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare
Safet Hoxha, gjyqtar
Radomir Laban, gjyqtar
Remzie Istrefi-Peci, gjyqtare dhe
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është dorëzuar nga Eset Berisha, nga Prizreni (në tekstin e mëtejme: parashtruesi i kërkesës).

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës e konteston Aktvendimin [Rev. nr. 107/21] të 16 marsit 2021 të Gjykatës Supreme në lidhje me Aktvendimin e Gjykatës së Apelit [Ac. nr. 4710/20] të 12 nëntorit 2020.

Objekti i çështjes

3. Objekti i çështjes së kësaj kërkesë është vlerësimi i kushtetutshmërisë së aktvendimit të kontestuar, me të cilin parashtruesi i kërkesës pretendon shkeljen e të drejtave të tij të garantuara me nenet 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] dhe 54 [Mbrotjtja Gjyqësore e të Drejtave] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta) dhe nenin 6 [E Drejta për një Proces të Rregullt] të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejme: KEDNJ).

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në paragrafët 1 dhe 7 të nenit 113 [Jurisdiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, në nenin 22 [Procedimi i kërkesës] dhe 47 [Kërkesat individuale] të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe në rregullin 32 [Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve] dhe 59 [Llojet e vendimeve] të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura para Gjykatës Kushtetuese

5. Më 26 gusht 2021, parashtruesi i kërkesës e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
6. Më 1 shtator 2021, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtarin Safet Hoxha gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Selvete Gërxhaliu-Krasniqi (kryesuese) Remzie Istrefi-Peci dhe Nexhmi Rexhepi, anëtarë.
7. Më 7 shtator 2021, Gjykata njoftoi parashtruesin e kërkesës për regjistrimin e kërkesës dhe një kopje të kërkesës ia dërgoi Gjykatës Supreme.
8. Më 8 qershor 2022, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

9. Në bazë të shkresave të lëndës, parashtruesi i kërkesës ka qenë i emëruar si drejtor i përgjithshëm i Autoritetit të Aviacionit Civil të Kosovës (në tekstin e mëtejme: AACK) me Vendimin [nr. 07/83] të 11 janarit 2019 të Qeverisë së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Qeveria e Kosovës).
10. Më 12 maj 2020, Qeveria e Kosovës, përmes Vendimit nr. 01/30, parashtruesin e kërkesës e kishte shkarkuar nga pozita e drejtorit të përgjithshëm të AACK-së, dhe në vend të tij kishte emëruar një ushtrues detyre të drejtorit.
11. Më 21 maj 2020, parashtruesi i kërkesës parashtroi padi kundër vendimit të Qeverisë së Kosovës në Gjykatën Themelore në Prishtinë – Departamenti për Çështje Administrative për shkak të anulimit të vendimit me propozimin për shtyerjen e ekzekutimit të Vendimit nr. 01/30 të Qeverisë së Kosovës.

12. Më 22 maj 2020, Gjykata Themelore–Departamenti për Çështje Administrative përmes Aktvendimit [A. nr. 867/2020] u shpall jo kompetent në pikëpamje lëndore për të gjykuar këtë çështje juridike, dhe lëndën ia dërgoi Departamentit të Përgjithshëm të Gjykatës Themelore në Prishtinë (në tekstin e mëtejshëm: Gjykata Themelore).
13. Më 8 shtator 2020, Gjykata Themelore, përmes Aktvendimit [C. nr. 2854/20], refuzoi si të pabazuar propozimin për caktimin e masës së sigurimit të propozuar nga parashtruesi i kërkesës i cili kishte kërkuar që të aprovohet si e bazuar masa e sigurimit të kërkesëpadisë dhe të obligohet e paditura që të përmbahet nga të gjitha veprimet administrative me qëllim të përzgjedhjes dhe emërimit të drejtorit të përgjithshëm të AACK-së, deri në vendosjen sipas kërkesëpadisë së paditësit.
14. Në një datë të pasaktësuar, parashtruesi i kërkesës paraqiti ankesë në Gjykatën e Apelit kundër Aktvendimit të Gjykatës Themelore me të cilin u refuzua propozimi për caktimin e masës së sigurimit.
15. Më 12 nëntor 2020, Gjykata e Apelit, përmes Aktvendimit [Ac. nr. 4710/20], refuzoi si të pathemeltë ankesën e parashtruesit të kërkesës dhe e vërtetoi Aktvendimin e Gjykatës Themelore C. nr. 2854/20.
16. Më 4 dhjetor 2020, parashtruesi i kërkesës paraqiti revizion pranë Gjykatës Supreme kundër Aktvendimit të Gjykatës së Apelit, për shkak të shkeljeve thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, dhe kërkoi që të ndryshohet Aktvendimi i Gjykatës së Apelit dhe Gjykatës Themelore dhe të aprovohet propozimi për masë të sigurimit.
17. Më 16 mars 2021, Gjykata Supreme përmes Aktvendimit [Rev. nr. 107/2021] hodhi poshtë si të palejuar revizionin e parashtruesit të kërkesës, ushtruar kundër Aktvendimit të Gjykatës së Apelit.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

18. Parashtruesi i kërkesës e konteston Aktvendimin [Rev. nr. 107/2021] e 16 marsit 2021 të Gjykatës Supreme, me pretendimin se i njëjti është nxjerrë në shkelje të të drejtave dhe lirive themelore të tij të garantuara me nenet 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] dhe 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] të Kushtetutës dhe nenin 6 [E Drejta për një Proces të Rregullt] të KEDNJ-së.
19. Parashtruesi i kërkesës pretendon se Gjykata Supreme me hedhjen poshtë të revizionit, ka gabuar në arsyetimin e saj për shkak se *“arsyetimi i kësaj gjykate është i pasaktë sepse propozimi për masë të sigurimit është çështje e ndarë nga çështja kryesore, për të cilën zhvillohet procedurë e njëjtë, rrjedhimisht edhe e drejta për të kërkuar revizion kundër vendimit të gjykatës së shkallës së dytë, ashtu siç lejohet edhe revizioni kundër aktgjykimit (neni 228, par. 2 LPK-së)”*.
20. Tutje, parashtruesi i kërkesës thekson se Gjykata Supreme, duke hedhur poshtë si të palejuar revizionin, i ka shkelur atij të drejtën që të kërkojë gjykim të drejtë të garantuar me nenin 31 të Kushtetutës si dhe të drejtën e tij për mbrojtje gjyqësore të drejtave të garantuara me nenin 54 të Kushtetutës. Ai thekson se është detyrim i gjykatave për të zgjidhur çështjen kontestuese dhe rrjedh në bazë të nenit 2, paragrafi 3 të Ligjit nr.03/L-006 për Procedurën Kontestimore.

21. Në fund, parashtruesi i kërkesës i propozon Gjykatës që: (i) të deklarojë kërkesën e pranueshme; (ii) të konstatojë se Gjykata Supreme ka shkelur të drejtat e tij të garantuara me nenin 31 dhe 54 të Kushtetutës; dhe (iii) të anulojë Aktvendimin e Gjykatës Supreme Rev. nr. 107/21 dhe çështjen ta kthejë në rigjykim dhe rivendosje.

Dispozitat relevante kushtetuese dhe ligjore

Neni 31

[E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm]

1. Çdokujt i garantohet mbrojtje e barabartë e të drejtave në procedurë para gjykatave, organeve të tjera shtetërore dhe bartësve të kompetencave publike.
 2. Çdokush gëzon të drejtën për shqyrtim publik të drejtë dhe të paanshëm lidhur me vendimet për të drejtat dhe obligimet ose për cilëndo akuzë penale që ngrihet kundër saj/tij brenda një afati të arsyeshëm, nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e themeluar me ligj.
- (...)

Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut

Neni 6

(E drejta për një proces të rregullt)

1. Çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e krijuar me ligj, e cila do të vendosë si për mosmarrëveshjet në lidhje me të drejtat dhe detyrimet e tij të natyrës civile, ashtu edhe për bazueshmërinë e çdo akuze penale në ngarkim të tij. Vendimi duhet të jepet publikisht, por prania në sallën e gjykatës mund t'i ndalohej shtypit dhe publikut gjatë tërë procesit ose gjatë një pjese të tij, në interes të moralit, të rendit publik ose sigurisë kombëtare në një shoqëri demokratike, kur kjo kërkohej nga interesat e të miturve ose mbrojtja e jetës private të palëve në proces ose në shkallën që çmohet tepër e nevojshme nga gjykata, kur në rrethana të veçanta publiciteti do të dëmtojte interesat e drejtësisë.
- (...)

LIGJI Nr. 03/L-006 PËR PROCEDURËN KONTESTIMORE

Revizioni kundër aktvendimit

Neni 228

228.1 Palët mund të paraqesin revizionin vetëm kundër aktvendimeve të formës së prerë me të cilat përfundon procedura e gjykatës së shkallës së dytë.

228.2 Nuk lejohet revizioni kundër aktvendimeve nga paragrafi 1 i këtij neni në kontestet në të cilat nuk do të ishte i lejuar revizioni kundër aktgjykimit.

Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

22. Gjykata së pari vlerëson nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuar më tej me Ligj dhe me Rregullore të punës.

23. Në këtë drejtim, Gjykata, fillimisht, i referohet nenit 113.1 dhe 113.7 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, i cili përcakton:

Neni 113

“1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.

[...]

7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.

24. Gjykata, më tej, i referohet neneve 47 [Kërkesa individuale], dhe 48 [Saktësimi i kërkesës] të Ligjit, të cilët përcaktojnë:

Neni 47
[Kërkesa individuale]

“1. Çdo individ ka të drejtë të kërkojë nga Gjykata Kushtetuese mbrojtje juridike në rast se pretendon se të drejtat dhe liritë e tij individuale të garantuara me Kushtetutë janë shkelur nga ndonjë autoritet publik.

2. Individ i mund ta ngritë kërkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.

Neni 48
[Saktësimi i kërkesës]

“Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj”.

25. Për sa i përket përmbushjes së këtyre kriterëve, Gjykata konstaton se parashtruesi i kërkesës është palë e autorizuar, i cili konteston një akt të një autoriteti publik, përkatësisht Aktvendimin e Gjykatës Supreme [Rev. nr. 107/2021], të 16 marsit 2021, pasi i ka shteruar mjetet juridike të parapara me ligj.
26. Megjithatë, Gjykata shqyrton nëse janë përmbushur kriteret e përcaktuara me nenin 49 [Afatet] të Ligjit dhe rregullin 39 [Kriteret e pranueshmërisë], respektivisht paragrafin (1) (c) të Rregullores së punës. Ato përcaktojnë si në vijim:

Neni 49 i Ligjit
[Afatet]

“Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajve. Afati fillon të ecë që nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor ...”.

Rregulli 39 i Rregullores së punës
[Kriteret e pranueshmërisë]

“(1) Gjykata mund ta konsiderojë një kërkesë të pranueshme nëse:

[...]

c) kërkesa parashtrohet brenda katër (4) muajsh nga dita kur vendimi i mjetit të fundit efektiv juridik i është dorëzuar parashtruesit, dhe [...].”

27. Në lidhje me sa u tha më sipër, Gjykata rikujton se afati 4 (katër) muaj fillon nga “vendimi i fundit” në procesin e shterjes së mjeteve juridike, me të cilin është refuzuar ankesa e parashtruesit (shih *mutatis mutandis*, rastin e Gjykatës Kushtetuese KI120/17, parashtrues: *Hafiz Rizahu*, Aktvendim për papranueshmëri, i 7 dhjetorit 2017, paragrafi 30; KI115/20, parashtrues *Muharem Rama*, Aktvendim për papranueshmëri, i 2 dhjetorit 2021, paragrafi 39; si dhe rastin e GJEDNJ-së, *Paul dhe Audrey Edwards kundër Mbretërisë së Bashkuar*, nr. 46477/99, Vendim i 14 marsit 2002).
28. Gjykata rikujton po ashtu se parashtruesi i kërkesës duhet t'i shterojë të gjitha mjetet juridike të cilat pritet të jenë efektive dhe të mjaftueshme. Vetëm mjetet efektive mund të merren parasysh nga Gjykata, pasi parashtruesi i kërkesës nuk mund të zgjasë afatet kohore strikte të parapara me Ligj dhe Rregullore të punës, duke u përpjekur të ushtrojë mjete juridike që nuk janë të lejuara ose duke u ankuar në institucionet të cilat nuk kanë kompetencë që të ofrojnë mbrojtje të të drejtave për të cilat ankohet parashtruesi i kërkesës (shih, *mutatis mutandis*, rastet e Gjykatës Kushtetuese: KI120/17, parashtrues *Hafiz Rizahu*, Aktvendim për papranueshmëri, i 7 dhjetorit 2017, paragrafi 31; KI112/19, parashtrues *Ilir Kabashi*, Aktvendim për papranueshmëri, i 2 dhjetorit 2019, paragrafi 38; KI115/20, parashtrues *Muharem Rama*, cituar më lart, paragrafi 40; si dhe rastin e GJEDNJ-së, *Fernie kundër Mbretërisë së Bashkuar*, nr. 14881/04, Vendim i 5 janarit 2006).
29. Gjykata vëren se procedura ndaj parashtruesit të kërkesës e zhvilluar para gjykatave të rregullta në lidhje me propozimin e tij për masë të sigurimit, kishte përfunduar me Aktvendimin e Gjykatës së Apelit [Ac. nr. 4710/2020] të 12 nëntorit 2020, përmes së cilit ishte refuzuar ankesa kundër Aktvendimit të Gjykatës Themelore.
30. Më tej, Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës paraqiti edhe kërkesën për revizion në Gjykatën Supreme, duke pretenduar shkelje të dispozitave të procedurës kontestimore dhe të së drejtës materiale.
31. Sa i përket Aktvendimit të Gjykatës Supreme i cili kontestohet nga parashtruesi i kërkesës, Gjykata vëren se në Aktvendimin [Rev. nr. 107/2021] të 16 marsit 2021, Gjykata Supreme nuk është marrë me pretendimet kryesore ankimore të parashtruesit, por ekskluzivisht me çështjen e natyrës procedurale në lidhje me llojin e mjetit juridik i cili është paraqitur nga parashtruesi në Gjykatën Supreme.
32. Lidhur me këtë, Gjykata vëren se Gjykata Supreme kishte konstatuar se në pajtim me dispozitat përkatëse ligjore të Ligjit për Procedurën Kontestimore (në tekstin e mëtejme: LPK), në nenin 228.1 është paraparë që palët mund të paraqesin revizion vetëm kundër aktvendimeve të formës së prerë me të cilat përfundon procedura e gjykatës së shkallës së dytë.
33. Në lidhje këtë, Gjykata i referohet Aktvendimit [Rev. nr. 107/2021], të Gjykatës Supreme, që hodhi poshtë si të palejuar revizionin e parashtruesit të kërkesës me

arsyetimin se: “Duke u nisur nga kjo gjendje e çështjes, Gjykata Supreme e Kosovës, ka gjetur se në rastin konkret, aktvendimi i goditur nuk e ka cilësinë e aktvendimit me të cilin përfundon procedura në mënyrë të plotfuqishme. Kështu, sipas dispozitës së nenit 228.1 LPK-së, është paraparë që palët mund të paraqesin revizionin vetëm kundër aktvendimeve të formës së prerë me të cilat përfundon procedura e gjykatës së shkallës së dytë. Megjë, me aktvendimin e goditur nuk përfundohet procedura kontestimore në këtë çështje juridike në formë të prerë, sipas kësaj dispozite revizioni kundër aktvendimit të goditur nuk është i lejuar, prandaj kjo gjykatë revizionin e ka hedhur poshtë si të palejueshëm”.

34. Në bazë të kësaj, Gjykata vëren se në pajtim me Aktvendimin e Gjykatës Supreme [Rev. nr. 107/2021], parashtruesi i kërkesës e ka paraqitur mjetin e palejuar juridik në Gjykatën Supreme, e cila në këtë rast edhe e ka hedhur poshtë si të palejuar.
35. Për më tepër, Gjykata rikujton se, në rastin e parashtruesit të kërkesës, pas pranimit të Aktvendimit të Gjykatës së Apelit [Ac. nr. 4710/2020] të 12 nëntorit 2020, asgjë nuk e ka ndaluar atë t'i drejtohet Gjykatës Kushtetuese. Megjithatë, ai ka përdorur mjete juridike, si revizionin kundër Aktvendimit [Ac. nr. 4710/2020] të Gjykatës së Apelit, i cili nuk kanë qenë i lejuar me ligj.
36. Rrjedhimisht, si “vendim i fundit”, sipas nenit 49 të Ligjit është Aktvendimi i Gjykatës së Apelit [Ac. nr. 4710/2020], i 12 nëntorit 2020, me të cilin ishte refuzuar ankesa e parashtruesit të kërkesës, dhe i cili ishte përfundimtar dhe i paapelueshëm (shih rastet e Gjykatës Kushtetuese nr. KI112/19, parashtrues *Ilir Kabashi*, Aktvendim për papranueshmëri, i 2 dhjetorit 2019, paragrafi 43; KI23/19, parashtrues *Agim Hoxha*, Aktvendim për papranueshmëri, i 29 tetorit 2021, paragrafi 93; KI115/20, parashtrues *Muharem Rama*, cituar më lart, paragrafi 51).
37. Andaj, Gjykata rikujton se Aktvendimi i Gjykatës së Apelit [Ac. nr. 4710/2020], ishte nxjerrë më 12 nëntor 2020. Në bazë të datës së nxjerrjes së Aktvendimit të Gjykatës së Apelit, pra më 12 nëntor 2020, dhe datës së paraqitjes së revizionit nga ana e parashtruesit të kërkesës, e që është 4 dhjetori 2020, që dëshmohet përmes kërkesës për revizion e cila ndodhet në dosje të lëndës, Gjykata vëren se Aktvendimin e Gjykatës së Apelit parashtruesi i kërkesës e ka pranuar para 4 dhjetorit 2020, dhe me këtë, Gjykata konstaton se koha në mes të pranimit të Aktvendimit të Gjykatës së Apelit dhe të datës së dorëzimit të kërkesës së tij në Gjykatë, më 26 gusht 2021, ka kaluar periudhën kohore prej 4 (katër) muajsh.
38. Rrjedhimisht, Gjykata konkludon se kërkesa e parashtruesit të kërkesës në lidhje me Aktvendimin e Gjykatës së Apelit [Ac. nr. 4710/2020] të 12 nëntorit 2020, është dorëzuar pas afatit ligjor prej 4 (katër) muajsh.
39. Gjykata rikujton se qëllimi i afatit ligjor prej 4 (katër) muajsh, sipas nenit 49 të Ligjit dhe sipas rregullit 39 (1) (c) të Rregullores së punës, është që të promovojë siguri juridike, duke siguruar që rastet që kanë të bëjnë me çështje kushtetuese të trajtohen brenda një periudhe të arsyeshme dhe të parandalohet mbajtja në gjendje pasigurie për një periudhë të gjatë kohore e palëve dhe personave të tjerë të përfshirë në procese gjyqësore (shih Aktgjykimin e GJEDNJ-së *Mocanu dhe të tjerët kundër Rumanisë*, kërkesat nr. (10865/09, 45886/07 dhe 32431/08), të 17 shtatorit 2014, paragrafi 258; shih, gjithashtu Aktgjykimin e GJEDNJ-së *Lopes de Sousa Fernandes kundër Portugalisë*, nr. 56080/13, të 19 dhjetorit 2017, paragrafi 129; dhe, rastin e Gjykatës Kushtetuese nr. KI112/19, parashtrues *Ilir Kabashi*, Aktvendim për papranueshmëri, i 2 dhjetorit 2019, paragrafi 46; KI115/20, parashtrues *Muharem Rama*, cituar më lart, paragrafi 54).

40. Ky afat gjithashtu i mundëson parashtruesit potencial të kërkesës që të shqyrtojë nëse dëshiron të paraqesë kërkesë dhe, nëse dëshiron, të vendosë për ankesat dhe argumentet konkrete që duhet ngritur dhe në të njëjtën kohë lehtëson vërtetimin e fakteve në këtë rast, meqë me kalimin e kohës, çdo shqyrtim i drejtë i çështjeve të ngritura bëhet problematik (shih, Aktgjykimin e GJEDNJ-së *Sabri Güneş kundër Turqisë*, kërkesa nr. 27396/06, të 29 qershorit 2012, paragrafi 39; shih po ashtu edhe rastin e Gjykatës KI12/20, parashtruese e kërkesës *Hamijete Dinarama-Daija*, Aktvendim për papranueshmëri, i 6 nëntorit 2020, paragrafi 42; KI115/20, parashtrues *Muharem Rama*, cituar më lart, paragrafi 55).
41. Ky rregull specifikon afatin kohor për kontrollin e ushtruar nga Gjykata dhe paralajmëron individët dhe autoritetet shtetërore për afatin pas të cilit kontrolli i tillë nuk është më i mundur (shih Vendimin e GJEDNJ-së *Walker kundër Mbretërisë së Bashkuar*, nr. 34979/97, të 25 janarit 2000; shih, gjithashtu, Aktgjykimin e GJEDNJ-së, *Sabri Güneş kundër Turqisë*, të cituar më lart, paragrafi 40; shih po ashtu edhe rastin e Gjykatës KI53/18, parashtrues i kërkesës *Hajri Ramadani*, Aktvendim për papranueshmëri, i 6 dhjetorit 2018, paragrafi 45; KI115/20, parashtrues *Muharem Rama*, cituar më lart, paragrafi 56).
42. Andaj, mbi bazën e arsyetimeve të mësipërme, Gjykata konkludon se kërkesa e parashtruesit të kërkesës është dorëzuar jashtë afatit ligjor të përcaktuar me nenin 49 të Ligjit dhe me rregullin 39 (1) (c) të Rregullores së punës, dhe si e tillë është e papranueshme.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, me nenin 49 të Ligjit dhe në pajtim me rregullin 39 (1) (c) të Rregullores së punës, më 8 qershor 2022, njëzëri

VENDOS


- I. TË DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. T'UA KUMTOJË këtë Aktvendim palëve;
- III. TË PUBLIKOJË këtë Aktvendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit; dhe
- IV. Ky Aktvendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues


Safet Hoxha



Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese


Gresa Caka-Nimani